



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.812/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Kenan Berisha, kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Kaçanik nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Kenan Berisha, kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Kaçanik nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, pas Shpalljes së Rezultatit Përfundimtarë të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.11.2017 në ora 09:40, ka pranuar një apel nga Kenan Berisha, kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Kaçanik nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, në të cilin pretendon se në vendvotimin 0717D/01D i është keqpërdorur vota, pasi që sipas deklaratës së anëtarit të këshillit të vendvotimit ai ka pasur 15 vota ndërsa në rezultatin përfundimtar ka vetëm një votë. Më tej parashtruesi i ankesës ka theksuar se në vendvotimet: 0720D/01R dhe 0701x/01R ka pasur parregullsi pasi që disa vota nuk u janë shënuar fare disa kandidatëve dhe se te disa kandidat është ndryshuar nr. i votave në formular.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të ankuesit gjeti se, ankuesi nuk ka ofruar prova bindëse për të dëshmuar pretendimet për parregullsitë e cekura në apel. Prandaj Paneli apelin e ankuesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte bindëse dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara mirë dhe si i tillë apeli i ankuesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
ZL.Anr.812/2017 me datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



***Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.*